



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 4517/15 Prot.

Tiranë, më 14.08.2021

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 70, datë 14.08.2021

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Victoria Invest International" Shpk për keqinformim për qëllime kualifikimi, në **Lotin III** me objekt: "Mirëmbajtje me performancë Tiranë – Dajt - Qafë Mollë - Bizë, Qafë Priskë – Shkallë - Shëngjergj, Uzina e Traktorit - Lanabregas, Sauk – Farkë (93.1 km)" të procedurës së prokurimit "Tender i Kufizuar" me objekt: "Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror" të zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, (në vijim "AK").

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Victoria Invest International" Shpk, me NIPT L02712202J me adresë: Lagjia 28 Nëntori, Rruga 11 Nëntori, Pallati pranë Tatim Taksave, kati 2, Elbasan.

I. Arsytet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Victoria Invest International" Shpk, ka nisur nga shkresa e AK, dërguar APP, i cili ka raportuar skualifikimin e shoqërisë "Victoria Invest International" Shpk, për keqinformim për qëllime kualifikimi në **Lotin III** me objekt: "Mirëmbajtje me performancë Tiranë – Dajt - Qafë Mollë - Bizë, Qafë Priskë – Shkallë - Shëngjergj, Uzina e Traktorit - Lanabregas, Sauk – Farkë (93.1 km)" të procedurës së prokurimit "Tender i Kufizuar" me objekt: "Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror" të zhvilluar nga AK.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi, sipas parashikimeve të nenit 78/1/a të LPP, në të cilin pëcaktohet se: "Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi".

Vendimin Nr.70, datë 14.08.2021, APP ka vendosur të përjashtojë për 10 (dhjetë) muaj operatorin ekonomik "Victoria Invest International" Shpk me NIPT L02712202J nga e drejta për të fituar kontrata publike, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese faktin që, operatori ekonomik "Victoria Invest International" Shpk, nuk ka qenë i përjashtuar më parë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, ka keqinformuar, nuk ka ndërhyrë në dokumenta, nuk ka përfituar fonde publike, pasi është skualifikuar, keqinformimi ka ardhur si rezultat i marrëdhënieve kontraktuale të ofertuesit me qiradhënësin, megjithëse është përgjegjësia dhe detyrimi i shoqërisë qiramarrëse për t'u siguruar për disponueshmërinë e mjeteve, si dhe për vërtetësinë e deklarimeve në tender.